

Vendim nr. 157, datë 20.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 20.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 26 (A) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: ADRIANA KALAJA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1195, datë 17.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.
Pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 00-2025-1195, datë 17.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 17, 33, 124 e vijues, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Protokolle nr.1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues, 45 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*); nenet 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) në datën 02.03.2021 ka regjistruar kallëzimin penal nr. 55, datë 02.03.2021 të kërkuarës dhe të disa shtetasve të tjerë, pjesë të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, kundër Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, kryetarit të Bashkisë së Tiranës, drejtorit ekzekutiv të shoqatës “Impetus”, shtetasve D.M. dhe I.D., avokatë të Dhomës së Avokatisë, Tiranë, si dhe ndaj çdo personi tjetër që me veprimet ose me mosveprimet e tij ka përgjegjësi ligjore penale për padinë e depozituar nga shoqata “Impetus” në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për kryerjen prej tyre të veprave penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, “Shpërdorimi i detyrës”, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, të kryera në bashkëpunim, të parashikuara përkatësisht nga nenet 244, 245, 245/1, 248, 259, 260, 287-25 të Kodit Penal (*KP*).

2. Kallëzimi i paraqitur nga kërkuarja dhe shtetasit e tjerë u referohet dy proceseve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të regjistruara në të njëjtën kohë e të hartuara nga të njëjtët avokatë, me palë paditëse shoqatën “Impetus” dhe organizatën jofitimprurëse “Art Kontakt” (*OJF-ja “Art Kontakt”*), palë të paditura Bashkinë e Tiranës, Këshillin e Ministrave/Kryeministria, këshillin bashkiak, Tiranë, dhe Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia e Tiranës, me objekt: (i) anulimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.377, datë 08.06.2020, si akt i paligjshëm, (ii) anulimin e vendimit nr. 50, datë 14.05.2020 “Për miratimin e shembjes së godinës së Teatrit Kombëtar, të këshillit Bashkiak të Tiranës, si akt i paligjshëm; (iii) konstatimin e paligjshmërisë së veprimeve të prishjes së kompleksit të Teatrit Kombëtar; (iv) detyrimin e Bashkisë së Tiranës që me shpenzimet e veta të ndërtojë kompleksin e Teatrit Kombëtar në vëllimin dhe në pamjen që ishte përpara prishjes, datë 17 maj 2020.

3. Kallëzuesit kanë pretenduar se paditë e ngritura kanë qenë me natyrë korruptive, të ngritura në bazë të interesave dhe në favor të zyrtarëve të lartë, pasi mbi kërkesën për heqjen dorë

nga gjykimi të Drejtorit Ekzekutiv të OJF-së “Art Kontakt”, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pushimin e çështjes. Kallëzuesit kanë parashtruar se avokatët mbrojtës, nën ndikimin e funksionarëve të lartë, kanë kryer veprime aktive në ngritjen e padisë, me qëllim legjitimimin e Kryeministrit të Shqipërisë dhe kryetarit të Bashkisë së Tiranës në veprimet për shembjen e Teatrit Kombëtar.

4. Ndërkohë, Prokuroria e Posaçme, me vendimin e datës 18.03.2021, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti i rezultuar nga përmbajtja e akteve të administruara nuk përbën veprë penale të parashikuar nga nenet 244, 245, 245/1, 248, 259, 260, 287-25 të KP-së. Kundër këtij vendimi, në datën 06.04.2021, kanë paraqitur ankim kallëzuesit.

5. Me vendimin nr.115, datë 06.05.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) ka vendosur rrëzimin e ankimit, me arsyetimin se në analizë të pretendimeve të ankuesve, verifikimeve të kryera nga Prokuroria e Posaçme dhe veprave penale të kallëzuara, ka rezultuar se dyshimet në rastin konkret nuk përmbajnë indicie ose elemente të veprave penale të kallëzuara ose të ndonjë veprë tjetër penale, ndaj, me të drejtë, është vendosur mosfillimi i çështjes penale nga Prokuroria e Posaçme, pasi nuk ekziston asnjë fakt penal me natyrë korruptive. Po kështu, sipas asaj gjykate, duke mbajtur në konsideratë se njëra nga paditë në procesin administrativ është ende në gjykim dhe nuk është marrë një vendim përfundimtar për të, nuk mund të aludohet *apriori* se vendimmarrja do të jetë në favor të organit publik, aty ku fokusohet edhe pretendimi i kallëzuesve për akt korruptiv. Gjithashtu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, është konfirmuar edhe fakti se në Prokurorinë e Posaçme është regjistruar procedimi penal nr.29/2000, me palë kallëzuese “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”, dhe objekt i këtij hetimi penal janë veprimet ose mosveprimet e funksionarëve publikë në rastin e shembjes së Teatrit Kombëtar. Ajo gjykatë ka vlerësuar se në mungesë të indicieve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, në mungesë të ndonjë burimi prove të vlefshme, që minimalisht të krijojnë të dhëna të mjaftueshme se janë konsumuar elementet e veprës penale, organi procedues nuk mund të kryejë veprime të tjera hetimore, për kryerjen e të cilave vetë Kodi i Procedurës Penale (*KPP*) kërkon si parakusht ekzistencën e të dhënave të mjaftueshme se janë konsumuar elementet e veprave penale që pretendohet në këtë rast të jenë kryer. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kallëzuesit, të cilët kanë kërkuar prishjen e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, urdhërimin e Prokurorisë së Posaçme të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke përcaktuar edhe drejtimin e tyre.

6. Me vendimin nr. 233, datë 11.10.2021, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së

Shkallës së Parë me arsyetimin se kallëzuesit nuk kanë referuar përpara Prokurorisë së Posaçme fakte penale të kryera nga të kallëzuarit, të tilla që të tregojnë se ka dyshime të bazuara në prova se ata kanë kryer veprat penale objekt kallëzimi, por, përkundrazi, siç deduktohet nga akti i kallëzimit, kallëzuesit kanë referuar në mënyrë të përgjithshme dyshimin se subjektet e posaçme janë të korruptuara, i cili nuk përbën premisë për fillimin e një procedimi penal. Sipas asaj gjykatë, me të drejtë GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka gjetur të bazuar në ligj vendimin e Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit, sepse në asnjë fakt të referuar në kallëzimin e kallëzuesve nuk evidentohen shkelje penalisht të ndëshkueshme nga personat ose nga funksionarët e kallëzuar. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs ankuesit kallëzues.

7. Me vendimin nr. 00-2025-1195, datë 17.07.2025, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se shkaqet e paraqitura në rekurs nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit, si dhe nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për zhvillimin ose njësimin e praktikës gjyqësore, vendimi i ankimuar nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe, për pasojë, nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

8. Në datën 31.03.2026 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkeses

9. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

9.1. *Cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm duhej të konstatojnë se vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është marrë jashtë parashikimit të afatit 15-ditor, të përcaktuar në nenin 290 të KPP-së, duke i bërë në këtë mënyrë të cenueshme vendimmarrjet e tyre. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka shkelur për pasojë edhe parimin e barazisë përpara ligjit dhe funksionimin e shtetit të së drejtës.

9.2. *Pezullimin e efekteve ligjore të vendimit të Gjykatës së Lartë* deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës, në zbatim të nenit 45, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, vërehet se kërkuësja ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal që ka vendosur për ankimin e saj dhe të disa shtetasve të tjerë kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal në bazë të kallëzimit të paraqitur nga kallëzuesit, ndër të cilët edhe ajo. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, kërkuësja e justifikon interesin e saj në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar.

12. Për sa i përket *aspektit substancial* të legjitimitit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

13. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuësja ka kundërshtuar procesin gjyqësor, i cili, në thelb, ka të bëjë me kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin e saj dhe të kallëzuesve të tjerë, pjesë të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit ndaj Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, kryetarit të Bashkisë së Tiranës, drejtorit ekzekutiv të shoqatës “Impetus”, shtetasve D.M. dhe I.D., avokatë të Dhomës së Avokatisë, Tiranë, si dhe ndaj çdo personi tjetër që me veprimet ose me mosveprimet e tij ka përgjegjësi ligjore penale në lidhje me padinë e depozituar nga shoqata “Impetus” në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për kryerjen prej tyre të veprave penale të parashikuara nga nenet 244, 245, 245/1, 248, 259, 260, 287-25 të KP-së. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Posaçme ka vlerësuar se ndjekja penale nuk mund të fillojë, pasi nuk plotësohen elementet e domosdoshme të konfigurimit të veprave penale të pretenduara nga kallëzuesit, arsyetim i cili është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, GJKKO-ja e Apelit dhe, në vijim, edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses.

14. Duke mbajtur parasysh rrethanat e mësipërme dhe pretendimet në ankimin kushtetues individual, Kolegji vëren se procesi penal ndaj shtetasve të kallëzuar ka në objekt hetimin dhe eventualisht gjykimin e veprave penale dhe të autorëve të tyre. Ndjekja penale ushtrohet nga Prokuroria e Posaçme, e cila përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, që do të thotë se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit dhe është pikërisht prokuroria, organi i specializuar, që ushtron ndjekjen penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Për këtë arsye, në raste të tilla, gjykimi kushtetues nuk mund të vihet në lëvizje nga individ që pretendon se ka pësuar dëm nga vepra penale, bazuar vetëm në pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, pa provuar cenimin e ndonjë të drejte substanciale të lidhur drejtpërdrejt me procesin penal.

15. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kallëzimi penal ndaj personave të tretë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkueses në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të saj. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuësja nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjerë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Në përfundim, në kushtet kur një nga kriteret paraprake nuk plotësohet, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

17. Në kushtet kur çështja nuk plotëson kriteret paraprake për t'u shqyrtuar në seancë plenare, bazuar në nenin 45, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, Kolegji vlerëson se nuk ka vend për të vendosur pezullimin e efekteve ligjore të vendimit të Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.